



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 828/ prot.

Elbasan, më 15.7.2022

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.60 datë 30.06.2022 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për ndërtim të HEC Vardari, niveli II, nga Shoqëria Gerti Sh.P.K.”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Majlinda **PERRIU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.04.07.2022

Nr. 3147/6 prot

Nr.60 dt.30.06.2022

“Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për ndërtim të Hec Vardari Niveli II nga shoqëria GERTI shpk”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në ligjin Nr.57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, ligjin 10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me vendimin 684 datë 02.09.2020, në VKM nr.591 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1353 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM nr.592 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr 1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit kullosor”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë së Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me datë 30.06.2022 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor për ndërtimin e Hec Vardari Niveli II të sipërfaqeve :

- a. Heqje nga fondi pyjor i sipërfaqes 0.003 ha që zë vepra e marrjes 2/1 dhe 0.004 ha që zë vepra e marrjes 2/2 në ngastrën 28c në ekonominë pyjore Kostenjë
- b. Heqje nga fondi pyjor i sipërfaqes 0.01 ha që zë bazeni i presionit në ngastrën 39c të ekonomisë pyjore Neshtë-Prevall


2. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sek. i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT

Shefki Bahiti





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA LIBRAZHD
Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit
RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

Nr _____ Datë _____ / _____ /2022

“Për dhëniën e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullësor publik për ndërtim të Hec Vardari Niveli II nga shoqëria GERTI shpk”

Bazuar në Ligjin Nr.57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Vendimin nr. 1353 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar, Vendimin 1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondi kullësor” i ndryshuar, Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit e të Bashkisë Librazhd sqaron si më poshtë:

-Pyjet dhe kullotat e territorit të bashkisë me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020 kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Librazhd sipas listës së inventarit (shtojca 18) .

-Në VKM nr.1353 datë 10.10.2008 i ndryshuar me Vendimin nr.591 datë 9.10.2018 citojmë

Pika 5 bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronjat “a” dhe “b” shfuqëzohen.
- b) Shkronja “ç” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“ç) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor me vendim të Këshit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do të nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor”

-Në VKM 1374 datë 10.10.2008 i ndryshuar me Vendimin nr.592 datë 9.10.2018 citojmë

Pika 6 bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronjat “a” dhe “b” shfuqëzohen
- b) Shkronja “d” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“d) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullësor me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullësore e cila do të nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullësor”

I kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë “vazhdimin e procedurave të heqjes së sipërfaqes” që zënë veç e marrjes 2/1 me sipërfaqe 0.003 ha dhe vepra 2/2 me sipërfaqe 0.004 ha si dhe bazeni i presonit me sipërfaqe 0.01 ha të kërkuar nga shoqëria “GERTI” shpk në mënyrë që Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Mjedisit Bashkisë Librazhd të vazhdojë procedurat e mëtejshme .

Përgj. Menaxhimit
Ing.Qerim FACJA

Drejtori
Ing.Aleksander BRAZHDA